THE GLOBAL LEADERSHIP SUMMIT

# *Projekto të nesërmen*

**SUMMIT GUIDE**

*I dashur Udhëheqës,*

*Mirësevjen* **NË SAMITIN BOTËROR TË UDHËHEQËSISË.**

*Merr frymë thellë.*

**PYET VETEN:** *po të mund të projektoje të ardhmen tënde, si do të ishte?*



**NË ORËT QË VIJOJNË, GJEJ HAPËSIRËN** *të mendosh dhe të ëndërrosh.*

**KE GJETUR KOHËN TË INVESTOSH NË TË NESËRMEN TËNDE.** *Përqafoje.*

*Le t'i japim jetë të nesërmes.*

David Ashcraft
President & CEO
**Global Leadership Network**



# #GLS24 SCHEDULE



Craig Groeschel



Kindra Hall



Dan Owolabi



Mike Krzyzewski (Coach 'K')



Jo Saxton



Molly Fletcher



Erwin Raphael McManus



Amy C. Edmondson

## Organizator

**Fondacioni Wilberforce**
wilberforce.org.al


Michael Jr.


Arthur C. Brooks


Joni Eareckson Tada


Will Guidara


Carey Lohrenz


Marcus Buckingham


David Ashcraft


Megan Fate Marshman


Dr Krish Kandiah





## Craig Groeschel

Themelues dhe Pastor, Life.Church;
Autor i mirënjohur

- https://x.com/craiggroeschel
- https://www.instagram.com/craiggroeschel
- https://www.facebook.com/craiggroeschel
- https://www.linkedin.com/company/craiggroeschel/

## Rreth Craig

I njohur në gjithë botën si udhëheqës i udhëheqësve, Craig Groeschel është themeluesi dhe pastori drejtues in kishës Life.Church, e renditur nga Glassdoor si Vendi #1 Place për të Punuar për dy vjet rresht. Kisha Life.Church njihet për përdorimin e teknologjisë në shërbim të misionit, dhe ka krijuar aplikacionin YouVersion Bible, i cili është instaluar në më shumë se gjysmë miliardë pajisje në mbarë botën. Craig është drejtues i një nga podkasteve më të mira: *Craig Groeschel Leadership Podcast*. Si autor i librave bestseller në *New York Times*, libri i tij më i ri është "*Think Ahead: 7 Decisions You Can Make Today for the God-Honoring Life You Want Tomorrow*."

## LEJE TË KESH FIKSIM

Gjithçka që të rrethon të shtyn drejt përputhjes dhe mediokritetit. Je trajnuar për të qenë mesatar. Fiksimet na i kanë mpakur dhe neutralizuar. Po sikur të kemi hequr dorë nga një forcë madhore? Dëgjoni Craig Groeschel ndërsa ju sfidon që ta ri-mendoni fiksimin dhe ta vini në shërbim të një jete të shquar e të shkëlqyer. Në këtë fjalë, identifiko tre mënyra se si fiksimi strategjik të jep shkëndijën për një ndikim më të madh.

### SKICA

- Rruga më e shkurtër drejt mediokritetit
- Leje të kesh fiksim
  - Fokusohu pareshtur
  - Përkujdesuni thellë
  - Përkushtohu plotësisht
- Fiksimi BALENË *(Whole-Hearted All-Encompassing Life Endeavor)*
- Gjej fiksimin tënd

> "Fiksimet t'i kanë mpakur dhe neutralizuar. Po sikur të kenë qenë një nga forcat e tua më të mëdha?"
>
> —CRAIG GROESCHEL

# MË THELLË

1. **Fiksime Strategjike:** Craig sugjeron tre fusha kyçe që udhëheqësi t'i ketë fiksim. Cila nga këto tre fusha është më e vështirë për ty?

2. **KRIJO LISTËN "Mos-i-bëj":** Udhëheqësit e zënë nuk ndryshojnë botën: udhëheqësit e fokusuar po. Një nga gjërat më shpirtërore për udhëheqësin është të mësojë të thojë Jo. Çfarë duhet shtuar në listën tënde?

**Lista "Mos-i-bëj"**

- [ ]
- [ ]
- [ ]
- [ ]
- [ ]

3. **Cili është FIKSIMI YT BALENË? (Puna Gjithëpërfshirëse me Gjithë Zemrën)** Nëse nuk e di mirë, mendoje tani për disa minuta.

4. **VEPRO:** Ku duhet të kalosh nga një pasion i arsyeshëm në një fiksim të paarsyeshëm? Mendo një hap konkret për të shkuar më thellë në atë drejtim.

## TË JAPIM LEJE TË KESH FIKSIM

**Çfarë fiksimi mund t'i sjellësh kësaj bote?**


Craig GROESCHEL
1 NORMAL is BORING
2 GREATNESS BORN in the EXTREMES
What do you LOVE
WHAT BREAKS YOUR
What drives you CRAZY?
Talking to the LEADERS...
PERMISSION to OBSESS
SOCIETY CONDITIONS US FOR CONFORMITY
MEDIOCRITY and AVERAGE
AVERAGE NEVER CHANGED the WORLD
WHOLE HEARTED ALL ENCOMPASSING LIFE ENDEAVOR
1 FOCUS
BUSY IS NORMAL NOT WORLD CHANGING FOCUS IS
NO NO NO NO
to DON'T LIST
Nehemiah was doing a great work "I CAN'T COME DOWN"
2 CARE DEEPLY
your people matter...
APPRECIATE more
OBSESS about ENCOURAGEMENT
3 COMMIT COMPLETELY
level 10 attracts more 10s
INVOLVED
COMMITTED
GLS 2024 DESIGN YOUR TOMORROW
@catherinetillydesign






## Kindra Hall

Eksperte e Tregimtarisë; Autore Bestseller

https://x.com/kindramhall
https://www.instagram.com/kindrahall
https://www.facebook.com/kindrahallfan
https://www.linkedin.com/in/kindrahall/


## Rreth Kindrës

Kindra Hall është autore e shquar dhe ish Chief Storytelling Officer e Revistës Suksesi. Ajo është bërë eksperte për tregimtarinë në biznes dhe më gjerë. Gartner dhe Forbes kanë thënë se libri i saj i parë, "Stories that Stick," "mund të jetë një nga librat e biznesit që ia vlen më shumë për t'u lexuar." Në maj 2024 doli edhe libri i saj më i ri, "The Story Edge: How Leaders Harness the Power of Stories to Win in Business," i cili ndihmon udhëheqësit të frymëzojnë dhe të komunikojnë më mirë me skuadrat dhe organizatat e tyre. Kindra ka ndihmuar marka të njohura si Target, Univision, United Way, USO dhe Farmers Insurance. Ajo frymëzon njerëzit dhe ekipet të komunikojnë më qartë vlerën e kompanisë, produkteve, dhe individualitetit duke përdorur tregimtarinë strategjike.

## MBREH FUQINË E TREGIMIT

Tregimtaria e mirë është pjesë kritike e udhëheqjes. Tregimi është element kyç për të ngjallur interesim, për të ndërtuar konsensus, dhe për të frymëzuar veprim. Kindra Hall na ndihmon të shohim tregimtarinë si një talent që duhet përdorur më shpesh. Në këtë fjalë, mëso si të gjesh, të thurësh, dhe të shprehësh tregime me vlerë. Fito besim në aftësinë tënde për të përdorur gjuhën universale të tregimtarisë.

### SKICA

- Kur të mungon një faqe
- Pse ka efekt tregimtaria
- Strategji tregimtarie
- Dy gjërat më të rëndësishme

"Ji bujar me tregime. Trego shpesh që njerëzit të të kuptojnë. Trego shpesh që njerëzit të kuptojnë veten."

—KINDRA HALL

1. **MBUSH HENDEKUN ME TREGIME:** Kindra shpjegon si të përdorim tregimet për të mbushur hendekun midis informacionit—iniciativat dhe vlerat e organizatës, etj.—dhe zbatimit në realitet. Kur shihni organizatën tuaj, ku ju zë syri hendek, dhe çfarë tregimesh mund ta mbushin? Mundohuni të shkruani të paktën tre.

| Hendeku/Situata | Tregimi |
|---|---|
| | |
| | |
| | |

2. **GJEJ TREGIMIN TËND:** Kemi të gjithë histori; çështja është tek zhbllokimi i tyre. Për këtë punë mund të shfrytëzojmë vlerat në jetën tonë dhe të zbulojmë historitë tona unike. Për ta nisur, shëno disa vlera unike (për veten ose organizatën) dhe kur i keni parë të vihen në provë ose në veprim.

| Vlera | Histori e Vlerës në Provë/Veprim |
|---|---|
| | |
| | |
| | |

3. **VEPRO:** Çfarë hapi konkret mund të marrësh nga kjo bisedë që si udhëheqës të fillosh të vësh në punë fuqinë e tregimeve?

## LIDHU ME GJUHËN UNIVERSALE TË TREGIMIT

**Çfarë veprimi do të bësh për ta vënë fuqinë e tregimtarisë në shërbim të punës tënde si udhëheqës?**



the STORY of PHYSICS CLASS
Harness the POWER of STORY
Gravity... things go up things go down and the story of WILD THING
REAL LIFE APPLICATION... FILL the GAPS with STORIES
CRASH
1 STORIES are our EDGE
2 STORIES STICK
MIDDLES are MESSY but... LEAD to QUESTIONS about WHAT COMES NEXT
DESIGN YOUR TOMORROW
GLS 2024
FIND the STORY
• make a list of Values
• make a list of People
HARD STORIES?? TELL THEM
CRAFT the STORY
• IDENTIFIABLE CHARACTERS
• INCLUDE EMOTIONS
• SPECIFIC MOMENTS
• DETAILS
WORKING PRINCESS!
BUILDING CASTLES and DREAMS
THE MOST IMPORTANT STORY IS the ONE WE TELL OURSELVES
Kindra HALL
@catherinetillydesign





## Mike Krzyzewski, “Coach K”

Trajner; Folës;
Profesor

## Rreth Mike

Dinamik, frymëzues, dhe me pasion, trajneri i ekipit të basketbollit të meshkujve të Duke University që udhëhoqi Team USA në fitoren e tre medaljeve të arta në Lojërat Olimpike, Mike Krzyzewski (Trajneri K) është mjeshtër novacioni—si për ekipe, edhe për individë e organizata, duke i nxitur drejt suksesit që nuk e prisnin as vetë. Trajneri K skicon qartë skemën për arritjen e suksesit duke motivuar, dhe duke ofruar strategji për të ndërtuar besim, komunikim, dhe bashkëpunim. Ndoshta më i suksesshmi trajner basketbolli në histori, është shquar me shumë arritje: numrin rekord të fitoreve (1202) në NCAA Division 1, rekordin për hyrjen në Final Four (13; pesë herë Kampionë të NCAA, i dyti në gjithë kohërat), më shumë medalje ari si krye-trajner në Lojërat  Olympic (3; 2008, 2012, dhe 2016) dhe shumë të tjera. Ai është autor i dy librave bestseller në New York Times, anëtar i Naismith Memorial Basketball Hall of Fame, Bashkë-Themelues i Qendrës Coach K për Udhëheqësine dhe Etikën, dhe Profesor i Praktikës së Udhëheqësisë në Fakultetin e Biznesit (Fuqua School of Business) të Duke University.

## FITORE NËPËRMJET BASHKËPUNIMIT DHE UDHËHEQJES

Kudo që gjen drejtues dhe udhëheqës do dëgjosh sa vlerë ka puna në ekip, por realizimi i bashkëpunimit mbetet një nga detyrat më të vështira për udhëheqësin. Si trajner, Mike Krzyzewski ka rrënjosur motivimin—tek individët dhe tek ekipi—që çdo individ të jetë në mendësi pozitive, të përdorë të gjitha aftësitë e veta, dhe të mos e pengojë frika e dështimit. Le të dëgjojmë njohuritë që ka mësuar dhe parimet e sprovuara që ka përdorur në karrierën e tij legjendare. Mëso prej tij teknika motivuese, mjeshtëri udhëheqësie, strategji bashkëpunimi, si të ndërtosh vetëbesimin, efektin jetësor të besimit dhe komunikimit—që mund të zbatohen në çdo nivel të orvatjeve personale dhe profesionale.

### SKICA

- Katër elementet e udhëheqjes
  - » Zhdërvjelltësia
  - » Përshtatshmëria
  - » Përgjegjshmëria
  - » Qëndrimi
- Dy këshilla për ekipet:
  - » Krijoni standarde
  - » Përcaktoni vlerat
- Forca!

# Mike Krzyzewski, “Coach K”

> “Koshat kanë rëndësi, por jo aq sa njerëzit që i bëjnë.”
>
> —**MIKE KRZYZEWSKI**

## MË THELLË

1. **ZHDËRVJELLTËSI:** Trajneri K e përshkruan zhdërvjelltësinë si aftësi që të "lexosh": të jesh fleksibël dhe të vendosësh drejtimin e udhëheqjes në një çast. Në shkallën nga 1 në 10, ku e vlerëson veten për fleksibilitetin që shfaq? Si të është dashur të jesh fleksibël në ekipin tuaj?

**Fleksibiliteti**

1 2 3 4 5 6 7 8 9 10

PAK SHUMË

2. **PËRSHTATU PËR REZULTATE:** Aftësia për t'u përshtatur ka shumë rëndësi në komunikim. Udhëheqësit me ndikim marrin përgjegjësinë të përshtatin mesazhin, qasjen, ose zërin që të komunikojnë si duhet dhe të nxjerrin rezultatet më të mira nga ekipet e tyre. Si të është dashur të përshtatësh stilin e komunikimit me anëtarët e ekipit ose familjes? Çfarë rezultati do të kishte një zë ndryshe për mesazhet kyçe që i jep ekipit?

3. **PËRGJEGJËSI:** Përgjegjshmëria ka dy drejtime: udhëheqësi kërkon përgjegjësi nga, dhe ekipi kërkon përgjegjësi nga udhëheqësi. Çfarë ritmi keni krijuar që punonjësit ose ekipet tuaja të mbajnë përgjegjësi për rezultatet e tyre? Çfarë sistemi përgjegjshmëri keni për udhëheqësit e lartë të ekipeve tuaja? Çfarë mundësish vini re për të rritur përgjegjshmërinë brenda ekipit tuaj?

4. **VEPRO:** Nga katër elementet që diskutoi trajneri, ku ke nevojë të punosh që tani? Si do ta bësh?

# Mike Krzyzewski, “Coach K”

**UDHËHEQËSIT E MËDHENJ JANË MJESHTRA TË EKIPIT.**

**Cili është mësimi kryesor për ty nga fjala e Trajnerit K?**


the A's of LEADERSHIP
(1) AGILITY to make a read and change direction
(2) ADAPTABILITY to change and communicate
ASK QUESTIONS hear from your team to become more agile
HOW DO YOU FEEL? WHAT DO YOU THINK?
(3) ACCOUNTABILITY and (4) ATTITUDE
VICTORY thru Teamwork + LEADERSHIP
1 STANDARDS all the EGOS under one umbrella as a team
OWNERSHIP
2 VALUES value based teams last FOREVER
LET'S GO!!!
COACH K
Mike KRZYZEWSKI
GLS 2024 DESIGN YOUR TOMORROW
@catherinetillydesign





# Arthur C. Brooks

Profesor në Harvard; Autor bestseller

https://x.com/arthurbrooks
https://www.instagram.com/arthurcbrooks
https://www.facebook.com/ArthurBrooks
https://www.linkedin.com/in/arthur-c-brooks/

## Rreth Arturit

Arthur C. Brooks është Profesori i katedrës Parker Gilbert Montgomery për Praktikën e Udhëheqësisë në Organizatat Publike dhe Jo-fitimprurëse at fakultetin Kennedy të Harvardit dhe Profesor i Praktikës së Menaxhimit në Fakultetin e Biznesit të Harvardit, ku jep mësim kurse për udhëheqësinë dhe lumturinë. Ai gjithashtu shkruan për revistën The Atlantic, ku ka rubrikën e mirënjohur "Si Të Ndërtosh Jetën" ("How to Build a Life"). Brooks ka botuar 13 libra, ndër të cilët librin #1 në listën bestseller të New York Times për vitin 2023 "Build the Life You Want: The Art and Science of Getting Happier" me bashkë-autore Oprah Winfrey, dhe librin #1 për vitin 2022, "From Strength to Strength: Finding Success, Happiness, and Deep Purpose in the Second Half of Life." Ai flet anembanë botës për lumturinë njerëzore dhe punon për të ngritur mirëqenien në kompani private, universitete, agjenci publike, dhe organizata të shoqërisë civile.

## MË TË LUMTUR NË NJË BOTË TË PALUMTUR

Është kollaj të vrenjtesh kur vetmia është në rritje, marrëdhëniet formohen me vështirësi, dhe shumë vende janë nën ndikimin "kulturës së përbuzjes" dhe polarizimit politik në rritje. Evidenca flet qartë: Në pothuajse çdo vend të botës, lumturia është në rënie. Dëgjojmë Arthur Brooks që ofron një strategji të qartë për të dalë nga kjo vorbull. Përfitoni mjete praktike për t'i mposhtur këto prirje duke eksploruar thelbin e shkencës së lumturisë, duke e vënë në jetë çdo ditë dhe duke e ndarë me të tjerët.

### SKICA

- Përkufizimi i lumturisë
  - » Ëndja
  - » Kënaqësia
  - » Kuptimi
- Zakonet e më të lumturve
  - » Besimi
  - » Familja
  - » Miqtë
  - » Puna me kuptim
- Bota në dhimbje
- Më shumë dashuri

> "Mund të shfaqim atë udhëheqje që duam të shohim nga figurat publike të vendit tonë."
>
> —ARTHUR C. BROOKS

# MË THELLË

**1. MUNDIMI PËR LUMTURI:** Arturi ngre idenë që lumturia përbëhet nga tre makronutrientë. Nga cili prej tre përbërësve nuk ke sa duhet?

**2. LËVRO ZAKONET E LUMTURISË:** Për më shumë lumturi, Arturi na këshillon t'u përkushtohemi katër zakoneve: besimit, familjes, miqve, dhe punës me kuptim. Në shkallën nga 1 në 5, si e vlerëson veten për këto zakone? (1 = aspak mirë; 5 = shumë mirë.)

**Besimi**

○—○—○—○—○
1 2 3 4 5
aspak mirë … shumë mirë

**Familja**

○—○—○—○—○
1 2 3 4 5
aspak mirë … shumë mirë

**Miqtë**

○—○—○—○—○
1 2 3 4 5
aspak mirë … shumë mirë

**Puna me kuptim**

○—○—○—○—○
1 2 3 4 5
aspak mirë … shumë mirë

**3. SHPALLI LUFTË PËRBUZJES:** Me sa duket bota po bëhet më pak e lumtur dhe po vuajmë nga rritja e asaj që Arturi e quan "përbuzje," e cila është kombinim i dy faktorëve: zemërim dhe neveri. Që t'i rezistojmë përbuzjes, duhet të shkojmë përtej tolerancës e mirësjelljes dhe të përqafojmë thirrjen që "t'i duam armiqtë." Ai e përkufizon dashurinë me fjalët "të dëshirosh me vullnet të mirën e tjetrit." Ndërsa mendon mbi këtë bisedë, cilin grup (ose individ) ndjen sfidë ta duash? Si do të dukej konkretisht "të dëshirosh me vullnet të mirën" për ata?

**4. VEPRO:** Çfarë hapi nga fjala e Arturit mund të hedhësh që të rritesh në lumturi? Çfarë hapi nga kjo fjalë mund të hedhësh që t'i shpallësh luftë përbuzjes?

## HIDH HAPIN E RADHËS.

Cila pjesë e fjalës së Arturit të la mbresë dhe po e përvetëson?


the SCIENCE of HAPPINESS
(NOT a FEELING)
the WORLD today...
• SCREENS...
• CORONAVIRUS...
• HATE! NOT ANGER
DISGUST
CONTEMPT
GETTING happier IN AN UNHAPPY WORLD
MICRONUTRIENTS OF THE HAPPINESS DIET
1 ENJOYMENT
PLEASURE + PEOPLE + MEMORY
2 SATISFACTION
JOY AFTER STRUGGLE
3 MEANING
THE WHY
COHERENCE + PURPOSE + SIGNIFICANCE
CAN'T GET NO...
BECAUSE IT'S IMPERMANENT...
PAIN
SUFFERING
ACHIEVEMENT
HAVES
WANTS
LOVE your ENEMIES
CHANGE the WORLD
STAND UP to the MAN
BECOME a MISSIONARY
DON'T GO IT ALONE
the HABITS
1 FAITH the path away from myself
2 FAMILY BIOLOGICAL LINK to SELF
3 FRIENDS USELESS not WORTHLESS
4 WORK EARN thru MERIT
SERVE OTHERS
QUIZ...
1 WHY WERE YOU BORN?
2 WHAT WOULD YOU GIVE YOUR LIFE FOR?
GLS 2024 DESIGN YOUR TOMORROW
Arthur C. BROOKS
@catherinetillydesign





# Megan Fate Marshman

Teaching Pastor,
Speaker and Author

https://x.com/meganfate
https://www.instagram.com/meganfate/?hl=en
https://www.facebook.com/meganfatemarshman
https://www.linkedin.com/in/megan-marshman-ba909a20/

## Rreth Megan

Si folëse në kisha, konferenca, and universitete në gjithë botën, Megan Fate Marshman ëhstë një zë prijës për këtë brez. Ajo po kryen Doktoraturën për Shërbesën e Krishterë duke qenë njëkohësisht pastore e mësimdhënies në kishën Willow Creek Community Church dhe Drejtor i Shërbesave em Gratë në Hume Lake Christian Camps. Ajo kujdeset edhe për gratë në kishën e saj, Arbor Road në Long Beach, Kaliforni. Megan ka botuar studimin e Biblës *Beautiful Word: John* (Fjala e Bukur: Gjoni) në 2022, ka shkruar librin dhe studimin e Biblës *Meant for Good* (2020) *SelfLess* (2017), dhe librin *7 Family Ministry Essentials* (2015) me bashkëautoren Dr. Michelle Anthony. Në gusht 2024, u botua libri i saj më i ri, *Relaxed: Walking with the One Who is not Worried about a Thing* (Në Paqe: Ecim me Atë që nuk Shqetësohet për Asgjë).

## NË PAQE

Mundohemi shpesh të bëjmë shumë për Zotin—pa Zotin. Në këtë fjalë, Megan Fate Marshman na sugjeron që si udhëheqës shërbëtorë të Jezuit, mund të ketë ardhur koha që të heqim dorë nga performanca shpirtërore, të refuzojmë prirjen për të jetuar nën presion, dhe të gjejmë lirinë për të ecur me Perëndinë dhe drejt Tij, me hapa të qetë, një nga një.

### SKICA

- 'Mirë' dhe 'Shumë mirë'
- Zoti krijoi
- Zoti bekoi dhe urdhëroi
- Nuk besuan që ishin të bekuar
- Por Zoti bekon sërish ... e sërish ... e sërish



Get a chapter from Megan's new book, "Relaxed":

glni.org/meganfate

# Megan Fate Marshman

> “Mendojmë se nxitës që të rriten të tjerët është zgjuarësia jonë — nuk është. Është vërtetësia jonë.”
>
> — **MEGAN FATE MARSHMAN**

## MË THELLË



1. **BEKIMI DHE VEPRAT.** Megan thotë se biem shpesh në kurthin që bëjmë për të marrë bekim, ndërsa duhet të kuptojmë që jemi bekuar që të jemi të aftë të bëjmë. Në çfarë fushe të jetës e sheh që bie në këtë kurth? Si mund ta ndryshosh këtë?

2. **TË DËGJOSH ËSHTË TË MËSOSH TË DUASH:** Megan na kujton që nëse nuk na njohin, nuk dinë si të na duan. A mund të identifikosh një marrëdhënie që ke dëshirë ta forcosh? Çfarë mund të ndash me të tjerët që t'u japësh mundësinë të të njohin më mirë dhe të të duan më mirë?
   Si do e plotësoje këtë fjali? *Po të më njihje vërtet, do të dije se ....*

3. **VEPRO:** Si udhëheqës, si mund ta bësh pjesë të jetës së përditshme praktikën që të bekosh të tjerët?

## ÇFARË TË KA VËNË NË DUKJE PERËNDIA NË KËTË FJALË?

**Si do reagosh?**



Relaxed
Describe Jesus in one word:
'Relaxed' - Dallas Willard
1 GOD CREATED...
· HOW AND FOR WHAT WERE YOU CREATED?
· 'GOOD' VS 'VERY GOOD' = WHOLE AND COMPLETE NOT LACKING ANYTHING YOU NEED TO LIVE THE PURPOSE YOU WERE DESIGNED FOR.
· ...ON PURPOSE WITH A PURPOSE
2 GOD BLESSED AND COMMANDED ...
· "DO TO BE BLESSED" VS "BLESSED SO THEY CAN DO"
· WHERE DOES THE SOURCE OF YOUR LIFE COME FROM?
· WHAT ARE YOU WORKING FROM, NOT WORKING FOR?
· BY DESIGN WE NEED EACH OTHER AND CREATED FOR COMMUNITY.
· IF YOU REALLY KNEW ME, YOU WOULD KNOW
· WHO REALLY KNOWS YOU?
· 'LONELINESS IS THE LEPROSY OF THE MODERN WORLD' - MOTHER TERESA
DO THEY KNOW HOW TO LOVE YOU?
3 THEY DIDN'T BELIEVE THEY WERE BLESSED
ATTEMPTS TO FILL THE GAP
DESPAIR TEMPTATION (GIVING UP)
IMMORAL TEMPTATION (PURSUE A DIFFERENT STANDARD)
MORAL TEMPTATION (BECOME BETTER BY YOURSELF)
4 GOD CONTINUES TO BLESS US
AGAIN ... AND AGAIN ... AND AGAIN
BELIEVING YOU ARE BLESSED
Megan Fate MARSHMAN
GLS 2024 DESIGN YOUR TOMORROW

“Gjatë gjithë jetës kam menduar për efektet afatgjata, duke sakrifikuar gjithmonë suksesin dhe duartrokitjet e menjëhershme për atë të së ardhmes.”

—FREDERICK LAW OLMSTED





# Të Reflektojmë

**Cilët udhëheqës admiroj më shumë dhe pse?**

**Çfarë nxitjesh kam ndjerë që duhet t'u kushtoj vëmendje?**

**Çfarë kam dëgjuar që duhet ta zhbiroj më tej?**

**Çfarë pyetjesh më dolën që duhet t'u gjej përgjigje?**

# Reagimet e Mia

**Çfarë përjetova që më ka frymëzuar?**

**Çfarë u tha me të cilën nuk jam dakord?**

**Çfarë përjetova që më solli gëzim?**

**Në botën time, çfarë më trishton apo më zemëron?**

**Me cilët folës pata më shumë rezonancë dhe pse?**

# Udhëheqja Ime

**Çfarë kam një pikë të fortë?**

**Çfarë kam një pikë të dobët?**

**Ku kam një mungesë si udhëheqës?**

**Çfarë kam në "*bucket list*" si udhëheqës?**

(*diçka që duhet bërë para se të vdes ose para se të largohem nga ky rol*)

# Marrëdhëniet e Mia

**Në ç'drejtime do të donin përgjegjësi ose kolegët që të rritem?**

**Çfarë do të më pasqyronte miku më i afërt për veten time?**

**Çfarë do të donte familja ime që ta përmirësoja?**

**Çfarë kam dëshirë të ndryshoj në marrëdhëniet me të tjerët?**

**NJË gjë nga Samiti për të cilën dua të veproj:**

Inspire & Equip

Global Leadership Network